VENDIM
Nr.866, datë 18.6.2008

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.343, DATË 27.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E BURIMEVE DHE TË PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË DËMEVE PASURORE TË SHKAKTUARA NGA AKSIDENTI TEKNOLOGJIK I GËRDECIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.343, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesa e ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët:

"… dhe vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në Gërdec, dhe të listave me emrat e individëve e të personave fizikë e juridikë, që do të kompensohen…".

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë shifra "…1 572 milionë lekë…" zëvendësohet me "…2 507 900 412 (dy miliardë e pesëqind e shtatë milionë e nëntëqind mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë…".

b) Në shkronjën "a", shifra "…150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë…" zëvendësohet me "…469 000 000 (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë) lekë...".

c) Në shkronjën "c" shifra "…622 000 000 (gjashtëqind e njëzet e dy milionë) lekë…" zëvendësohet me "…1 238 900 412 (një miliard e dyqind e tridhjetë e tetë milionë e nëntëqind mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë...".

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha